



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.____.2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIT**

Data: 10.02.2026

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) : “BENAKS -94” shpk me Nipt J73804663H, me adrese Rruga nacionale Pogradec-Korçe, Km 1, krah i djathte ,prane kryqezimit Buçimas , Bucimas, Pogradec, si dhe administrator z. Besnik Ibi.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) X

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ **JO** ☐

Nëse po, të jepen dhënat : “NIKA” shpk, me Nipt J76705047U, me adrese: Shkoder Lagjia “Vasil Shanto”, Bulevardi “Skenderbeu”, godina 8-kateshe, kati I I-re, Zona kadastrale 8593, nr .pasurie5/587, perfaqesuar nga drejtuesi ligjor znj. Shpresa NIKA.

Tipi i Kontratës: **Punë publike**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **“Procedurë e Hapur”-“pune”- “Elektronike”.**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-71874-12-11-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *Objekti: “Rehabilitim i rrugës Rrëmenj- Gështenjas”.*

Fondi limit: **19 999 885 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e teteëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **2 muaj nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: data 12.12.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: *Data: 15.12.2025,*

Numri: Nr.79

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE **“EM-EA CONSTRUCTION” shpk** Numri i NIPT-t M568227701I

Vlera: 12 781 349, 85 (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet e nëntë presje tetëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. OE **“INFINIT” shpk** Numri i NIPT-t J74304623M

Vlera: 14 525 036, 1 (katërmëdhjetë milion e pesëqind e njëzet e pesë mijë e tridhjetë e gjashtë presje një) lekë pa tvsh .

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. (BOE): **“ADA-CO” shpk** Numri i NIPT-t K64112603J dhe
“REJ” shpk, Numri i NIPT-t J93711608Q

Vlera: 16 726 013 (gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e gjashtë mijë e trembëdhjetë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. OE **“DEHA 2010” shpk** Numri i NIPT-t L03425410B

Vlera: 13 000 924, 63 (trembëdhjetë milion e nëntëqind e njëzet e katër mijë presje gjashtëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. OE **“R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h** (dega e shoqërisë RSM COMPANY)

Numri i NIPT-t L04803001U

Vlera: 13 243 830 (trembëdhjetë milion e dyqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. OE **“VARAKU E” shpk** Numri i NIPT-t J61902509S

Vlera: **18 643 869, 66 (tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë presje gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

7. OE **“BENAKS -94” shpk** Numri i NIPT-t J73804663H

Vlera: **15 569 960 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1.“EM-EA CONSTRUCTION” shpk Numri i NIPT-it M568227701I ,per arsyet e mëposhtme:

Nuk është arritur të paraqitet i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST. Konkretisht:

1.1 Operatori ekonomik “EM-EA CONSTRUCTION” shpk nuk përmbush pikën 2.2.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST, pasi nuk ka paraqitur bilancet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Pararësisht se operatori ekonomik ka deklaruar dhe vërteton se është krijuar rishtazi në treg (Qershor 2025) dhe sipas legjislacionit në fuqi, për shkak të kohës së shkurtër nga themelimi, xhiron vjetore ka arritur ta vërtetojë me faturat fiskale të vitit 2025 , të cilat përmbushin vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Ndërsa bilancet financiare për periudhën e plotë të vitit fiskal 2025 nuk janë maturuar dhe janë në vijim e sipër, autoriteti kontraktor pavarësisht deklaratës se është shoqëri e krijuar rishtazi nuk krijon bindjen dhe besimin se operatori ekonomik ka kapacitetin financiar për të përfunduar këtë objekt prokurimi, sepse operatori mund ta përmbush xhiron financiare , por kjo nuk tregon që operatori është me fitim apo me humbje për vitin fiskal të ushtrimit të aktivitetit të tij.

Gjithashtu bazuar në pikën 4 ,të nenit 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku thuhet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit . Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.”

Pra, për sa më sipër, oferta konsiderohet e pavlefshme.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. OE “INFINIT” shpk Numri i NIPT-t J74304623M ,per arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik deklaron në Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” se për përmbushjen e kësaj kontrate do të mbështetet në kapacitetet e shoqërisë “**L.T.E CONSTRUCTION**” shpk, me Nipt L78006801F. Ligji i prokurimeve (LPP) përcakton se Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

Nga ana tjetër, në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera,” të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, është sanksionuar e drejta për t’u mbështetur në kapacitetet e subjektit mbështetës, por edhe rregullat dhe mënyra e kësaj mbështetjeje. Në pikën 7, të nenit të sipërmendur, citohet gjithashtu se: **“Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”**

Në rastin konkret shoqëria “**L.T.E CONSTRUCTION**” shpk, me Nipt L78006801F, është deklaruar subjekt mbështetës edhe për operatorin ekonomik “**VARAKU E**” shpk, me Nipt J61902509S, i cili është gjithashtu ofertues në këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, oferta e OE “INFINIT” shpk konsiderohet e pavlefshme.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3.OE “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h (dega e shoqerise meme RSM COMPANY)

Numri i NIPT-t L04803001U ,per arsyet e mëposhtme:

Ofertuesi në fjalë aktualisht rezulton të ketë një kontratë për punë publike të lidhur me AK, të cilën nuk ka arritur ta përmbushë me sukses brenda afateve kohore të percaktuara.

Në mbështetje të LPP-së dhe Rregullave të Prokurimit Publik, konkretisht në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, në pikën 3 shkronja e) ku citohet se: “Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: e) “Operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate”.

Për sa më sipër, në kushtet kur ofertuesi pjesëmarrës ka një kontratë me AK, e cila në thelb ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e saj, kjo nuk i jep siguri AK ta kualifikojë ofertën si të vlefshme dhe referuar nenit të sipërpërmendur **është ndër kushtet detyruese për t’u skualifikuar nga AK.**

Për sa më sipër, oferta e OE “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h (dega e shoqërisë RSM COMPANY) është e pavlefshme.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. OE “VARAKU E” shpk Numri i NIPT-t J61902509S ,per arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik deklaron në Shtojcën 8 “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” se për përmbushjen e kësaj kontrate do të mbështetet në katër subjekte të tjerë, nën cilësinë e mbështetësit. Konkretisht:

- 1- Në kapacitetet e shoqërisë “L.T.E CONSTRUCTION” shpk, me Nipt L78006801F.
- 2- Në kapacitetet e shoqërisë “LLAZO” shpk , me Nipt K24218401K.
- 3- Në kapacitetet e shoqërisë “NDERTUESI 2014”, me Nipt L46827004L.
- 4- Në kapacitetet e shoqërisë “LIS KONSTRUKSION”, me Nipt K66613407H.

Ligji i prokurimeve (LPP), përcakton se Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

Nga ana tjetër, në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, është sanksionuar e drejta, për tu mbështetur në kapacitetet e subjektit mbështetës por edhe rregullat dhe mënyra e kësaj mbështetjeje. Në pikën 7, të nenit të sipër përmendur, citohet gjithashtu se: “Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. **Subjekti**

mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

Në rastin konkret njëri nga mbështetësit e ofertës së “VARAKU E” shpk, është edhe shoqëria “L.T.E CONSTRUCTION” shpk, me Nipt L78006801F, i cili në të njëjtën kohë është deklaruar edhe subjekt mbështetës për operatorin ekonomik “INFINIT” shpk, me Nipt J74304623M, i cili është gjithashtu ofertues në këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, duke qenë se LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik e ndalojnë, që subjekti mbështetës, të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi, atëherë rezulton se oferta konsiderohet e pavlefshme.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. OE “DEHA 2010” shpk Numri i NIPT-t L03425410B ,per arsyet e mëposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit, te kryer nga KVO-ja, rezulton se OE nuk ka arritur te paraqesë të gjithë dokumentacionin e plotë dhe të saktë për të provuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim ashtu sic deklaroon në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në përputhje me DST-në. Konkretisht:

1. OE nuk përmbush pikën 2.3.8 të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST-së, (Makineri dhe Pajisje), si më poshtë:

Ndër të tjera në përmbushje të pikës së mësipërme, kërkohet disponimi i:

- 1 (një) kamioncine 3.5 ton dhe
- 4 (katër) Autoveteshkarkuese 7 -10 ton

Operatori ekonomik ka paraqitur kontratat e qerasë, për nj kamioncinë deri në 3.5 ton me targa AB452TL dhe dy autovetëshkarkuese 7-10 ton. Njëra me targa dhe MK4485A dhe tjera me targa AA749 DG .

Për secilin prej ketyre mjeteve janë paraqitur dokumentacionet e kërkuara sipas DST , por certifikata e transportit të mallrave, figuron të jetë “Për llogari të vetë”. Ndërkohë , që edhe pse janë mjete që janë dhënë me qera , që normalisht në mbështetje të legjislacionit shqiptar duhet të ishin mjete që figurojnë “Për të tretë”.

Pra, në analizë të sa më sipër cituar, OE ka paraqitur 3 kontrata qiraje për të 3 (dy) mjetet e kërkuara në DST, pavarësisht faktit se nuk i ka bashkëngjitur certifikata transporti për të tretë dhe me qira, bazuar në nënin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportët rrugore", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse".

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtëtohet se, certifikatat e paraqitura, rezultojnë të jenë dhënë në përdorim të vet pronarit të mjetit për kryerjen e transportit të mallrave me kamion/ kamionçinë (vetëm për llogari të veprimtarisë së vet). Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e OE të mallrave me mjetin e mësipërm do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa certifikatën përkatëse, transport i cili në zbatim të nënit 41 të ligjit "Për Transportët Rrugore" është i ndaluar. Mungesa e certifikatave të mësipërme, vërteton faktin se përdorimi i tij nga të tretë do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit "Për Transportin Rrugor".

Gjithashtu referuar Njoftimit të APP-së Nr.4916/2 Prot. Datë 14.07.2022, në rastin e mjeteve me qera ,mjetet nuk duhen të rezultojnë vetëm për përdorim vetjak , por për përdorim nga të tretët., citojmë: *“autoritetet/entet kontraktore duhet të jenë të kujdesshëm gjatë vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë, në rastet e mjeteve të marra me qira nga këta të fundit. Në këto raste, referuar dokumentacionit (leje qarkullimi, certifikatë e transportit të mallrave), mjetet nuk duhet të rezultojnë për përdorim vetjak, por për përdorim nga të tretët.”*

Për sa më sipër, oferta e Operatorit “DEHA 2010” shpk me Nipt L03425410B është e pavlefshme.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: **OE “BENAKS -94” shpk me Nipt J73804663H, me adrese Rruga nacionale Pogradec-Korçe,Km 1,krahu i djathte ,prane kryqezimit Buçimas , Bucimas, Pogradec, si dhe administrator z. Besnik Ibi, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 15 569 960 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh, është identifikuar si ofertues i sukseshëm.**

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETAR
Ilir XHAKOLLI